DRAMA E NJË TË BURGOSURI

Mesnatë. Kristi ndodhet i vetëm në qelinë e paraburgimit. Është arrestuar pasi ka vrarë vrasësin e të vëllait. Ndriçimi është i dobët dhe ai duket i zbehtë. Më tej, një gardian gjysmë i përgjumur, i mbështetur mbi faqen e murit.

Kristi: (*I ulur në gjunjë dhe me duar në formë lutjeje*) Përse o Zonja Shën Mëri nuk më mbrojte mua, birin tënd, që të mos bija në grackën e gjakut të ndezur prej marrisë e zemërimit? Përse lejove, që të sakrifikoja rininë time, jetën time, i kryqëzuar në kryqin e ndërgjegjes së përzier prej qytetari intelektual e katundari të egër? Unë asnjëherë nuk kam dashur të jem si ata dhe ti e di shumë mirë këtë gjë. E di, apo jo? Por, çmendurisht, tani unë jam njëri nga ata.

O Perëndi, nuk mund ta besoj! Unë, unë, uuu..., unë jam një vrasës... Ooh, ç'dhimbje e helmatisur! Po më rëndon shpirti nga gjëma e mëkatit. Ah, sikur shpirti të mund të ishte një send! Do ta shkulja me gjithë forcën prej trupit tim dhe do ta flakja në një humnerë të thellë. Dhe le të ndahej pastaj në shtatë miliard copëza të vogla pendimi e të merrte ndëshkimin e merituar. E urrej veten time. E urrej *Kristin*.

Do të doja të më mbetej vetëm trupi, se nuk mund ta mbaj më peshën e fajit. Është tepër e rëndë për një njeri si unë. Një njeri i pa shpirt është vetëm një shtazë dhe kështu më duket se po shndërrohem edhe unë. Ja, shiko duart! Sa ashpërsisht të forta që janë bërë. Më është rritur dhe mjekra; jam bërë si shumë leshator. Edhe kurrizin e kam të kërrusur. Rëndesa e gabimit nuk më lë të qëndroj drejt. As në këmbë nuk mund të ngrihem më. Ç'metamorfozë ironike!

(*Bërtet i inatosur*) Çfarë? Ju mendoni se unë nuk e doja vëllain tim? Ju jeni të gjithë të çmendur, të paaftë për të logjikuar! Ju urrej edhe juve! Po, po ju urrej! Po, ai ishte vëllai im, gjaku që furnizonte me jetë zemrën time të pastër. Po tani??? Tani nuk ka më jetë... Në zgavrën e zemrës sime të plagosur ka mbetur veç një errësirë verbuese e mbështjellë me vellon e vdekjes. Unë e doja jetën, doja dhe unë të jetoja, të ndryshoja botën, botën e egër të Veriut, të ndieja lumturinë e të qenurit një hero, kurse tani...

Kurse tani, bota e egër më ndryshoi mua. U bëra edhe unë zbatues i ligjeve të saj të rrepta. *O Shqipëri, nënë e egërr burrash të rreptë!* O Shqipëri, po unë kam edhe motra e vëllezër të tjerë! Morra gjakun e njërit, por hapa me duart e mia rrugën për të humbur të tjerët. U bëra shkak për të vazhduar në mënyrë të rrjedhshme këtë zinxhir krimesh absurde. Ooh, përse nuk munda ta thyeja dot këtë nyje gardiane, t'i ndaloja këto marrëzira dhe të shpëtoja botën?! *O Shqipëri, nënë e egërr burrash të rreptë...!*

Gardiani: (*I është prishur gjumi nga toni i rebeluar i të burgosurit*) Hej, ti atje! Mbylle gojën dhe fli gjumë, se po na prish qetësinë! (*Mbështet përsëri kokën te muri dhe fillon sërisht të dremisë*)

Kristi: Po, sigurisht zoti gardian! Do të hesht. Do të hesht, se edhe po fola nuk e ndryshoj dot atë që bëra. Do të hesht, që të mos i prish rehatinë drejtësisë. Le të flejë drejtësia. Të flejë e qetë dhe të mbështetet në murin pas të cilit fshihet një vrasës, ose një gjakës, siç themi ne andej nga Malësia. Fli drejtësi, mos e prish gjumin tënd të ëmbël! Mos i trazo ti ëndrrat! Fli, fli e qetë, ndërsa atje lart në Bjeshkë, një e shtënë prish ekuilibrat e jetës, për të rregulluar ekuilibrat e vdekjes...

K.K

KLEVISA KAPO